V E N D I M
Nr.144, datë 3.4.1991

PËR DETYRAT DHE FUNKSIONIMIN E "KOMITETIT TË RIOGANIZIMIT TË EKONOMISË".

Në zbatim të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.7476, datë 12.3.1991 "Për lejimin dhe mbrojtjen e pronës e të veprimtarive private", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Komiteti i Riorganizimit të Ekonomisë ka këto detyra dhe të drejta kryesore:

- Organizon, drejton dhe bashkërendon proceset e kalimit të pronës shtetërore në pronë private, të krijimit të sektorit të ri privat, si dhe të marrëdhënieve të tjera që lindin nga riorganizimi i ekonomisë.
- Në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, cakton kohën dhe afatin e kalimit të ndërmarrjeve e njësive shtetërore në pronë private dhe rregullat përkatëse të këtij kalimi.
- Ndihmon dhe kontrollon organet shtetërore të ekonomisë, në qëndër e në bazë, për zbatimin e plotë të rregulloreve dhe të kritereve të caktuara në dispozita të veçanta që lidhen me krijimin, veprimtarinë dhe mbrojtjen e pronës private.
- Në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, bashkërendon, studion, përpunon dhe përgatit aktet e nevojshme ligjore e nënligjore që lidhen me gjithë proçesin e riorganizimit të ekonomisë.
- Bën zbërthimin dhe konkretizimi e akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet, të cilat lindin nga kalimi i pronës shtetërore në pronë private.
- Bën vërejtje dhe jep mendime për projektet e akteve ligjore e nënligjore që përgatiten nga ministritë e institucionet e tjera qendrore për problemet që i përkasin fushës së veprimtarisë private.
- Bashkëpunon me organet financiare për zbatimin e legjislacionit fiskal, të veprimtarive aksionare, të çmimeve e të standardeve nga personat juridikë e fizikë privatë.
- Bashkërendon punën me ministritë e institucionet e tjera qëndrore për problemet që lindin nga bashkëpunimi i personave privatë fizikë e juridikë shqiptarë me persona fizikë e juridikë të huaj në fushën e investimeve, të shtrirjes dhe zgjerimit të këtyre veprimtarive etj.
- Jep pëlqimin për dhënien e autorizimit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore për shitjen ose dhënien me qira personave fizikë e juridikë të huaj, të ndërmarrjeve, njësive ose objekteve të veçantë dhe për investimet e reja që do të kryhen prej tyre.
- Jep pëlqimin për dhënien e autorizimit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore për kalimin në pronësi ose dhënien me qira personave fizikë e juridikë të huaj të ndërmarrjeve njësive ose objekteve të veçanta nga personat privatë fizikë e juridikë shqiptarë.
- Pezullon zbatimin e akteve nënligjore të nxjerra nga ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e rajoneve që bien në kundërshtim me aktet ligjore për problemet e riorganizimit të ekonomisë, deri në shfuqizimin e tyre nga organet kompetente.
- Kërkon të dhëna të ndryshme me karakter ekonomik nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e rajoneve, si dhe nga personat juridikë e fizikë privatë.

2. Komiteti i Riorganizimit të Ekonomisë është organ kolegjial e vendimor dhe përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe 9-11 anëtarë, kuadro e specialistë me përvojë në këtë fushë. Përbërja e tij miratohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Komiteti i Riorganizimit të Ekonomisë merr vendim me shumicë votash. Kur kryetari ka

mendime të kundërta me shumicën e anëtarëve të Komitetit, çështja i paraqitet Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

Komiteti i Riorganizimit të Ekonomisë ka aparatin e tij, i cili vepron sipas rregullores së brendshme të miratuar nga kryetari i këtij Komiteti.

Në planin e e vitit 1991 shtohen 130 mijë lekë për Komitetin e Riorganizimit të Ekonomisë, kurse struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë caktohen nga kryetari i këtij Komiteti.

3. Pagat e punonjësve të Komitetit të Riorganizimit të Ekonomisë të jetnë;

	Paga mujore në lekë
Kryetari	1400
Zëvendëskryetari	1100-1200
Përgjegjës sektori	1000-1100

- Pagat për institucione të tjera të aparatit të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.88, datë 24.6.1967, lidhja I-1 nr.2 "Pagat e punonjësve të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
FATOS NANO